



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPRJEČAVANJE KORUPCIE
THE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Për Parandalimin e Korrupsionit me datë 07.12.2022, mori:

V E N D I M

- I. Mbyllt rasti me nr. **AKK-DPK-06-1361/22**, për zyrtarin e lartë z. Luan Dalipi, Shef i Stafit të Kryeministratit të Republikës së Kosovës, për shkak së ështëshmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihaqet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-DPK-06-1361/22, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Luan Dalipi, Shef i Stafit të Kryeministratit të Republikës së Kosovës, është zhvilluar procedura e paraparë për trajtimin e situatave të konfliktit të Interesit.

Ky rast ka filluar të trajtohet sipas detyrës zyrtare pas raportimit nga jashtë më të cilën është ngritur dyshimi se i njëjti është bashkëpronar në biznes privat.

Sipas procedurës Agjencia fillimisht ka marrë informacione nga ARBK (Agjencia Për Regjistrimin e Bizneseve), ku është vërtetuar se zyrtari Luan Dalipi, figuron të jetë bashkë pronar dhe person i autorizuar i një biznesi privat, më emër "INTERTEL Kosovo L.L.C." .

Pas konfirmimit të informacionit Agjencia Për Parandalimin e Korrupsionit sipas procedurës së paraparë, fillimisht e ka njoftuar zyrtarin e lartë me një shkresë zyrtare informuese për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese, është mbajtur takim me zyrtarin e lartë dhe është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, zyrtari i lartë nuk mund të ushtroj edhe funksion menaxhues në biznes privat, sepse kjo është e ndaluar me nenin 13 (paragrafi 1) të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit, në të cilën thuhet:

1. *Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë private, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.*

Ndërsa me nenin 19 të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit parashihen masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave. Dispozitat e nenit në fjalë përcaktojnë se:

1. *Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrëthanave:
 - 1.1. transferon interesin privat dhe të drejtat në drejtimin e ndërmarrjes sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij ligji; [...];
 - 1.3. jep dorëheqjen nga detyrat, funksionet ose veprimtaritë që janë në konflikt ose të papajtueshme me funksionin e tij publik;
 - 1.4. dorëhiqet nga funksioni publik.*

Në ketë takimi me zyrtarin e lartë të quajtur ndryshe edhe si ballafaqim i fakteve, zyrtari i lartë z. Luan Dalipi, është pajtuar me gjeljet e Agjencisë, duke deklaruar se nuk ka pas njohuri në lidhje me kufizimet e parapara, por na ka njoftuar se biznesi për të cilin bëhet fjalë nuk është aktiv pra nuk zhvillon veprimtari me gjithë atë do të ndërmerr veprime të menjëershme në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrim të funksionit publik.

Agjencia pas komunikimit që ka pasur me zyrtarin në fjalë ka pranuar njoftimin, informacionin zyrtar, me të cilën na ka njoftuar se ka ndërmarr veprimet e nevojshme në institucionet kompetente duke e shuar në mënyrë vullnetare biznesin më emër "INTERTEL Kosovo L.L.C.".

Agjencia Për Parandalimin e Korrupsionit, konstaton se me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Luan Dalipi, Shef i Stafit të Kryeministrat të Republikës së Kosovës, janë krijuar rrethana të reja dhe ështëshmangur gjendjen e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Për Parandalimin e Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtore i Agjencisë Për Parandalimin e Korruptionit

Yll Buleshkaj

